



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 05 Dhjetor 2020

Nr: 01

UDHËZIM

PËRCAKTIMI I RREGULLAVE PËR NGRITJEN, CAKTIMIN DHE NJOFTIMIN E
VENDNDODHJES SË QENDRAVE TË VOTIMIT DHE PËRGATITJEN E HARTËS SË NJËSISË SË
VETËQEVERISJES VENDORE PËR ZGJEDHJET

Komisioni Rregulator, mbështetur në nenin 20, parografi 1, shkronja "a", parografi 3, nenin 46, paragrafët 1 dhe 2, nenin 50, parografi 3, nenin 52, nenin 62, nenin 93, nenin 108, parografi 7 dhe nenin 109, parografi 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

U D H Ë Z O N

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e rregullave që do të ndiqen nga organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, për caktimin e zonave dhe vendndodhjes së qendrave të votimit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave për njoftimin e Komisionit Qendoror të Zgjedhjeve (KQZ) lidhur me caktimin, ngritjen dhe vendndodhjen e qendrave të votimit, përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet, ku përcaktohen zonat e qendrave të votimit, adresat dhe lloji i objektit ku janë vendosur qendrat e votimit.

Neni 2

Përkufizime

1. Zona e qendrës së votimit është një zonë gjeografike, me territor kompakt dhe të pa shkëputur, brenda territorit të një bashkie, ose zone zgjedhore.
2. Qendër votimi është mjesidi i caktuar për zhvillimin e votimit, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor.
3. Numri i zgjedhësve për çdo qendër votimi nuk duhet të jetë më i vogël se 300 dhe më i madh se 1000 zgjedhës.

Data: 05 Dhjetor 2020

Nr. 01

Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet.



4. Institucionet e posaçme përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi. Qendra e votimit në këto institucionë ngrihet kur në to ndodhen mbi 15 zgjedhës.
5. Harta e njësisë së vetqeverisjes vendore për zgjedhjet, është harta që përgatit kryetari i njësisë së vetqeverisjes vendore, në të cilën janë vendosur kufijtë e zonave të qendrave të votimit dhe që përgatitet sipas përcaktiveve të këtij udhëzimi.

Neni 3

Kriteret për caktimin dhe ngritjen e qendrave të votimit

1. Vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për arsyet objektive apo të parashikuara në nenin 93, të Kodit Zgjedhor, kjo nuk është e mundur.
2. Qendrat e votimit krijohen:
 - a) për aq sa është e mundur në ndërtesa publike me hyrje të lirë;
 - b) në ndërtesa të institucioneve publike arsimore, kulturore dhe shëndetësore ku përfshihen, shkolla, çerdhe, kopshte, konvikte, qendra shëndetësore, qendra kulturore;
 - c) në institucionë të posaçme ku përfshihen: burgjet, vendet e paraburgimit si dhe spitalet ose institucionet e tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë përmë shumë se 3 ditë.
3. KQZ mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private, kur në zonën e qendrës së votimit ose në një zonë qendre votimi fjinje nuk ka mundësi objektive përmë përdorur një ndërtesë publike sipas parashikimeve të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni.

Kryetari i njësisë së vetqeverisjes vendore i propozon KQZ- së caktimin e qendrës së votimit në ndërtesë private në pronësi të personave fizikë ose juridik. Propozimi paraqitet me dy objekte alternative, planimetrinë përkatëse ose fotografi të ambientit, një përshkrim për lehtësitet që ofron objekti përmë zhvillimin normal të zgjedhjeve dhe që plotëson kriteret e përcaktuara në këtë nen. Bëjnë përjashtim rastet kur nuk është e mundur gjetja e një objekti alternativ.

4. Qendrat e votimit, nuk mund të krijohen:
 - a) në ndërtesa private, pa udhëzim të KQZ-së;
 - b) në çdo rast qendra e votimit nuk mund caktohet në banesa private;
 - c) në ndërtesa që përdoren nga administrata publike, me përjashtim të institucioneve arsimore, kulturore dhe shëndetësore;
 - ç) në ndërtesa që përdoren apo janë në pronësi, pjesërisht ose tërësisht, të një partie politike, kandidati, të afërmve të tij, ose kanë shërbyer si zyra elektorale gjatë fushatës zgjedhore.

Neni 4

Bashkimi i qendrave të votimit



Data: 05 Dhjetor 2020

Nr. 0 1

Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetqeverisjes vendore përmë zgjedhjet.

- Kur një zonë qendre votimi ka më pak se 300 zgjedhës, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore vendojnë ajo t'i bashkohet zonës së qendrës së votimit me numër më të madh zgjedhësish, më të afërt dhe me mundësi komunikimi rrugor.
 - Kur shuma e numrit të zgjedhësve të dy zonave të qendrave të votimit të bashkuara është më e vogël se 1000 zgjedhës, zgjedhësit votojnë në qendrën e re të votimit të caktuar pas bashkimit të zonave të qendrave të votimit.
 - Kur shuma e numrit të zgjedhësve të dy zonave të qendrave të votimit të bashkuara është më e madhe se 1000 zgjedhës, krijohen dy qendra votimi me numër përafërsisht të barabartë zgjedhësish. Në këtë rast qendra e re e votimit ngrihet, për sa është e mundur, në të njëjtën godinë me qendrën ekzistuese të votimit dhe numërtohet sipas sistemit unik kombëtar të numërtimit të qendrave të votimit.
- Për zonat rurale, si irregull, qendra e re e votimit, nuk është më larg se 5 km nga qendra e votimit që shkrihet.
- Në rast se nuk është e mundur të zbatohen të dy kriteret e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij nenit, kriteri i numrit të zgjedhësve dhe kriteri i largësisë, kriteri i numrit minimal të zgjedhësve ka përparësi.
- Numri i qendrës së votimit të shkrirë pezullohet dhe ky pezullim nuk ndikon në numërtimin ekzistues të qendrave të tjera të votimit.

Neni 5

Kriteret teknike dhe pajisjet e qendrës së votimit

- Mjedisi i qendrës së votimit, si irregull, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - të jetë me sipërfaqe jo më të vogël se 30 m^2 ;
 - të jetë sa më afër qendrës gjeografike të zonës së qendrës së votimit;
 - të jetë me ndriçim të mjaftueshëm;
 - të jetë në katet e para të objekteve.
- Komisioni Qendor i Zgjedhjeve merr masa për instalimin e videomonitorimit në qendrat e votimit, në mënyrë të tillë që të mos cënojë ose të rrezikojë kryerjen në fshehtësi të votimit.
- Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, merr masa për:
 - pajisjen e QV-së me tavolina, karrige apo pajisje të tjera, të mjaftueshme për anëtarët e KQV-së dhe vëzhguesit, sipas skemës tip të plan vendosjes, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
 - krijimin e lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuar;
 - vënien në dispozicion të Komisioneve të Qendrave të Votimit, të mjediseve të caktuara për qendra votimi, të pajisura me mjetet sipas parashikimeve të shkronjës "a" të këtij paragrafi, jo më vonë se 48 orë përpëra ditës së zgjedhjeve.

Neni 6

Harta e njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet



Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe përfshirjen e vendndodhjes së qendrave të votimit

dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet.



1. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit hartën e njësisë për zgjedhjet sipas kritereve teknike në lidhjen 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
2. Harta e njësisë përkatëse për zgjedhjet përgatitet në formë dixhitale (format dwg, shp ose pdf). Harta në format dixhital shoqërohet edhe me hartë të printuar në format jo më të vogël se A1.
3. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, dërgon në KQZ hartën e njësisë përkatëse për zgjedhjet, jo më vonë se 10 ditë nga shpallja e ekstraktit me përbërësit zgjedhorë.
4. KQZ-ja krijon dhe përditëson hartën e zonave të qendrave të votimit, si dhe krijon bazën e të dhënavë mbi vendndodhjet e qendrave të votimit, mbi bazën e informacionit të marrë nga kryetarët e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Neni 7

Informacioni për zgjedhësit me aftësi të kufizuara

1. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, dërgon në KQZ të dhëna të plota për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, të cilat përfshijnë:
 - a) qendrën/at e votimit ku janë të regjistruar zgjedhës me aftësi të kufizuara, numrin e tyre dhe llojin e paaftësisë, për çdo qendër votimi;
 - b) numrin e zgjedhësve të verbër të njësisë së vetëqeverisjes vendore.
2. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dërgon në KQZ, të dhënat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, brenda 60 ditëve nga dekretimi i datës së zgjedhjeve.

Neni 8

Shpallja dhe njoftimi i vendndodhjes së qendrave të votimit

1. Kryetari i njësisë së vetqeverisjes vendore:
 - a) cakton dhe shpall vendndodhjen e qendrave të votimit jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve;
 - b) cakton në katet e para të ndërtesave, si rregull, qendrat e votimit ku janë të regjistruar zgjedhës me aftësi të kufizuara;
 - c) dërgon në KQZ propozimet sipas parashikimeve të nenit 3, paragrafi 3, të këtij udhëzimi, brenda 60 ditëve nga dekretimi i datës së zgjedhjeve;
 - ç) njofton menjëherë Komisionin Qendorr të Zgjedhjeve dhe Komisionin e Zonës së Administrimit Zgjedhor për ngritjen e Qendrave të Votimit në institucione të posaçme, llojin e institucionit, dhe numrin e zgjedhësve;
 - d) afishon udhëzimin e KQZ për caktimin e vendndodhjes së qendrës së votimit në ndërtesë private, në hyrjen e qendrës të votimit përkatëse.



Data: 05 Dhjetor 2020

Nr. 0 1

Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet.

2. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, të paktën një herë në javë, si dhe sa herë i kërkohet nga KQZ-ja raporton për njoftimin me shkrim të zgjedhësve për kryerjen e lajmërimit me shkrim për çdo zgjedhës të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrave të votimit në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore.
3. Raportimi sipas parashikimit të paragrafit 2, dërgohet në adresën postare të KQZ-së.

Neni 9

Ndryshimi i vendndodhjes së qendrës së votimit nga KQZ

1. Komisioni Qendoror i Zgjedhjeve, brenda afateve të përcaktuara në nenin 62 të Kodit Zgjedhor, ndërhyr kryesisht ose me ankesë të përfaqësuesve të partive në KQZ, për të zbatuar kërkosat dhe kriteret për qendrën e votimit, numrin e zgjedhësve dhe vendndodhjen e tyre.
2. Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përvèç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja.
3. Pas vendimit të KQZ-së qendra e votimit nuk ndryshon.

Neni 10

Dërgimi i të dhënave për qendrat e votimit dhe i listës së zgjedhësve

1. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, menjëherë pas miratimit të listës së zgjedhësve, por jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, dërgon në Komisionin Qendoror të Zgjedhjeve dhe Komisionin e Zonës së Administrimit Zgjedhor përkatës, numrin e çdo QV-je, vendndodhjen e tyre, numrin përkatës të zgjedhësve në listën e zgjedhësve, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi, në letër dhe në formë elektronike të përshtatshëm për tu aplikuar në PEI.
2. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, menjëherë pas miratimit të listës së zgjedhësve, por jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, i dërgon KZAZ-ve përkatëse listën e zgjedhësve sipas formave të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të paragrafit 2 të nenit 48 të Kodit Zgjedhor.
3. Në rast se kompetencat e parashikuara në këtë nen nuk ushtrohen nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, detyrimet sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, përmblushen menjëherë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Neni 11

Sanksione administrative

1. Në rast të refuzimit të zbatimit të urdhërimeve të KQZ-së në lidhje me qendrat e votimit, KQZ-ja ndëshkon kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore me 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë



Data: 05 Dhjetor 2020

Nr. 0 1

Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit
dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet.

gjobë, sipas paragrafit 12, të nenit 62, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe njofton prefektin për zbatimin e udhëzimit për caktimin e qendrave të votimit.

2. Në rast mosraportimi nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas parashikimeve të nenit 8, paragrafët 2 dhe 3 të këtij udhëzimi, KQZ ndëshkon kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore me 3 000 (tre mijë) lekë deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë gjobë, sipas paragrafit 1, të neni 170, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.
3. Gjoba përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet sipas Kodit të Procedurës Civile.

Neni 12

Shfuqizime

Udhëzimi, nr.1, datë 12.12.2012, i Komisionit Qendoror të Zgjedhjeve, "Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet" shfuqizohet.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendoror të Zgjedhjeve.

Ilirjana NANO -

Kryetare



Arens ÇELA -

Anëtar



Dritan ÇAKA -

Anëtar



Helga VUKAJ -

Anëtare



Muharrem ÇAKAJ -

Anëtar





KRITERE TEKNIKE PËR PËRGATITJEN E HARTAVE TË NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE PËR ZGJEDHJET

Bashkitë duhet të përgatisin harta më vete për çdo njësi administrative në përbërje të saj sipas kritereve të mëposhtme:

A. Njësitë administrative, që kanë në përbërje të vet edhe fshatra, duhet të përgatisin hartën e njësisë me këta elementë :

- Kufijtë administrativë të njësisë administrative, pozicionin e të gjithë qyteteve/fshatrave të njësisë, rrjetin rrugor që përshkon njësinë, emërtimet e njësive fqinje.
- Në anë të hartës, të vizatohet një hartë skematike e bashkisë me kufijtë e njësive administrative të bashkisë, ku të vihet në dukje pozicioni i njësisë administrative.
- Në anë të hartës duhet të jenë listuar numrat e QV-ve me adresat përkatëse.
- Saktësia e hartës duhet të plotësojë kërkesat e saktësisë së hartave të shkallës 1:5000.
- Harta do të printohet në format A1
- Në rastin kur njësia administrative që ka në përbërje të vet edhe fshatra, për qytetin/qytetet në përbërje të tyre duhet të përgatitet hartë më vete që të plotësojë kriteret si në paragrafin B.

B. Njësitë administrative që përbëhen nga qytete duhet të përgatisin hartën e njësisë me këta elementë:

- Kufijtë administrativë të njësisë administrative; kufijtë e zonave të qendrave të votimit me numrat përkatës; plan - vendosjen e banesave me kodet përkatëse të numërtuar në bazë të ligjit Nr.9296, datë 21.10.2004, "Për verifikimin, identifikimin dhe regjistrimin e shtetasve nga njësitë e qeverisjes vendore"; emërtimin e godinave kryesore që shërbejnë për orientim në hartë si universitete (nëse ka), shkolla, spitale etj.; rrjetin rrugor me emërtimet përkatëse. Godinat ku ndodhen QV-të, të jenë të markuara dhe pranë të vendoset dhe numri i QV-së.
- Në anë të hartës, të vizatohet një hartë skematike e bashkisë me kufijtë e njësive administrative të bashkisë, ku të vihet në dukje pozicioni i njësisë administrative.
- Në anë të hartës duhet të jenë listuar numrat e QV-ve me adresat përkatëse.
- Saktësia e hartës duhet të plotësojë kërkesat e saktësisë së hartave në shkallën 1:2000.
- Harta do të printohet në format A0.


Miratuar me Udhëzimin nr. 01, datë 05 Dhjetor 2021

POSTER
INFORMUES

POSTER
EDUKUES

VOTUESI
LARGOHETT NGA
QV

Dera e QV-se



VOTIMI NË
DHOMËN E
FSHEHTËSISË

FLETA E VOTIMIT
HIDHET NË KUTINË
E VOTIMIT



IDENTIFIKIMI ELEKTRONIK
I VOTUESIT NË PËRMËJT PEI



Komisioni i gendrës se votimit




QV

GENDRE VOTIMI

QV

GENDRE VOTIMI

QV





Formular tip me të dhëna për qendrat e votimit

Qarku: _____

Bashkia _____

Të dhëna për QV-të dhe numrin e zgjedhësve në ekstraktin me përbërësit zgjedhorë /listën e zgjedhësve për Zgjedhjet e ... të datës

Nr. .	Njësia Administrative	Numri i QV	Nr.i zgjedhesve	Vendndodhja QV	Lloji i objektit publik privat i posaçëm	Te dhëna teknike të ambientit të QV-së			Zgjedhës PAK	
						superfaqja	dritare (po/jo, numri)	aksesi ne rrjetin elektrik	katë	numri
1										
2										
3										
4										
5										
6										
7										
8										
9										
10										
...										
..				Shuma						

Kryetari i Bashkisë

(emrë mbiemër firmë vullë)

Miratuar me Udhëzimin nr. 01, datë 05 Dhjetor 2020



Shenim 1: QV-të do të renditen brenda njësisë administrative duke filluar nga numri me i vogël te numri më i madh i tyre.

Shenim 2: Në fund duhet të jetë vendosur shuma e numrit të zgjedhësve për çdo njësi administrative dhe totali pér bashkimë.

Shenim 3: Afati i fundit pér sjelljen e këtij formulari në KQZ,

- a) të plotësuar me të dhënat e ekstraktit me përbërësit zgjedhorë jo më vonë se 10 ditë nga shpallja e ekstraktit me përbërësit zgjedhorë, pra jo më vonë se data ...
- b) të plotësuar me të dhënat e listës së zgjedhësve (listës përfundimtare), jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, pra jo më vonë se data

Shenim 4: Të dhënat e pëmendura më sipër duhet të dërgohen në KQZ në letër dhe në formë elektronike i përshtatshëm pér tu aplikuar në PEI dhe format excel, në adresën ... @cec.gov.al.